



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE**

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN
E MATURËS SHETËRORE PROFESIONALE**

TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:

**PROFILI MËSIMOR “MBËSHETJE E PËRDORUESVE TË
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE
KOMUNIKIMIT (TIK)”**

(DREJTIMI MËSIMOR “TIK”)

Tiranë, 2019

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve të profilit **“Mbështetje e përdoruesve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)”**, me strukturë 2+2, për provimin e detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- Programet e lëndëve teorike profesionale të drejtimit “Teknologji Informacioni dhe komunikimi (TIK)”, Niveli I (klasa 10 dhe 11-të);
- Programet e lëndëve teorike profesionale të profilit “Mbështetje e përdoruesve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)”, Niveli III (klasa e 12-të dhe 13-të).
- Udhëzimin e përbashkët të MASR dhe MFE nr. 40, datë 26.12.2018 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2019”.
- Rregulloren për zhvillimin e Maturës Shtetërore 2019 në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 780, datë 23.11.2018.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të “Teorisë profesionale të integruar”, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Qëllimi i provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale është vlerësimi i të nxënësve dhe arritjeve si dhe përzgjedhjen e nxënësve për arsimim të mëtejshëm.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin e detyruar të “Teorisë profesionale të integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për profilin mësimor **“Mbështetje e përdoruesve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)”** do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë

çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Ky program përmban rreth **30%** të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve të kulturës profesionale. Në këtë program janë përfshirë ato lëndë, të cilat përbëjnë bazën kryesore dhe thelbësore për formimin profesional të nxënësve.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të **“Teorisë profesionale të integruar”** në kuadrin e provimit të detyruar **“Teori profesionale e integruar”**, të Maturës Shtetërore Profesionale, për profilin mësimor **“Mbështetje e përdoruesve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)”**, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtme:

1. Rrjete kompjuterike, kl. 11.
2. Administrim sistemesh shfrytëzimi, kl. 12 dhe 13.
3. Arkitekturë kompjuteri dhe rrjetesh, kl. 12.
4. Algoritmikë dhe programim, kl. 12.
5. Sisteme multimediale, kl. 12 dhe kl. 13.
6. Baza të dhënash, kl. 13.

Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues

Nr.	Lëndët	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Rrjete kompjuterike	32	10
2	Administrim sistemesh shfrytëzimi	84	27
3	Arkitekturë kompjuteri dhe rrjetesh	57	19
4	Algoritmikë dhe programim	44	15
5	Sisteme multimediale	38	13
6	Baza të dhënash	50	16
	TOTALI	305	100%

Temat sipas lëndëve janë:

- a) **“Rrjetet kompjuterike”, kl. 11: (32 orë)**
- Topologjitë (Bus, Ring, Star, Mix). 4 orë
 - Mediat dhe teknikat e transmetimit me kabull (LAN dhe WAN), ndërtimi, kategoritë, specifikimet dhe fushat e përdorimit. 6 orë
 - Përbërësit aktivë të rrjetit, nyjet e rrjetit (kabllot, *hub*, *switch*, *repeater*, *bridge*, *router*, *gateway*, *network adapter*). 6 orë
 - Protokollin e Internetit (IP), caktimi i adresave dhe *subnetmask*-ave. 6 orë
 - Funksioni dhe ndërtimi i TCP-së dhe UDP-së. 4 orë
 - Protokollet e aplikacioneve (*http*, *ftp*, *smtp*, *pop*, *imap*, etj.). 6 orë
- b) **“Administrim sistemesh shfrytëzimi”, kl. 12 dhe kl. 13: (84 orë)**
- Përshkrimi, funksionet, instalimi, konfigurimi i një sistemi shfrytëzimi Windows. 3 orë
 - Mirëmbajtja dhe performanca e sistemeve të shfrytëzimit. 4 orë
 - Administrimi i përdoruesve dhe mjetet e kontrollit të panelit. 6 orë
 - Përshkrimi, funksionet, instalimi dhe startimi i një sistemi shfrytëzimi UNIX/LINUX. 2 orë
 - Sistemi i skedarëve dhe ruajtja e informacionit. 3 orë
 - Shell dhe X-Window. 4 orë
 - Menaxhimi i proceseve dhe shërbimeve të sistemit. 4 orë
 - Skriptimi në LINUX. 3 orë
 - Siguria, mbrojtja e të dhënave dhe e sistemit. 3 orë
 - Ndërtimi, karakteristikat, instalimi dhe konfigurimi fillestar i një sistemi shfrytëzimi Windows Server. 3 orë
 - Sistemi DNS (Domain name system). 3 orë
 - Krijimi i një domain-i. 3 orë
 - Regjistrimi i posteve të punës. 3 orë
 - Shërbimet në Active Directory. 4 orë
 - Administrimi i objekteve të Active Directory. 4 orë
 - Administrimi i grupeve. 3 orë
 - Menaxhimi i atributëve të burimeve të përbashkëta. 4 orë
 - Administrimi i aksesit të përdoruesve (DFS) 3 orë
 - Administrimi i profilit të përdoruesve. 3 orë
 - Administrimi i direktivave të grupit. 3 orë
 - Administrimi i printimit. 2 orë
 - Administrimi në distance dhe shërbimet fundore. 5 orë
 - Administrimi i disqeve fizike dhe logjike. 4 orë
 - Sigurimi, mbrojtja, restaurimi dhe përditësimi i sistemit. 5 orë

c) **“Arkitekturë kompjuteri dhe rrjetesh”, kl. 12:** **(57 orë)**

- Ndërtimi i kompjuterit. 3 orë
- Motherboard-i. 5 orë
- Procesorët. 4 orë
- Memoriet. 3 orë
- Kartat përshtatëse. 4 orë
- Hard disqet dhe pajisjet ruajtëse. 3 orë
- Pajisjet hyrëse dhe dalëse. 4 orë
- Konfigurimi, startimi dhe montimi i kompjuterit. 3 orë
- Laptopët dhe pajisjet e tjera të lëvizshme. 6 orë
- Printerët, skanerët, videoprojektorët. 4 orë
- Pajisjet e rrjetit dhe protokollet. 7 orë
- Konfigurimi klient server. 3 orë
- Interneti dhe www. 3 orë
- Mbrojtja dhe siguria në rrjeta. 5 orë

d) **“Algoritmikë dhe programim”, kl.12:** **(44 orë)**

- Pseudokodi, bllokskemat dhe simbolika e tyre. 2 orë
- Shprehja e algoritmeve nëpërmjet bllokskemave. 2 orë
- Algoritmet më të avancuar me bllokskemë (ciklet). 2 orë
- Programet nga krijimi në ekzekutim (roli i kompilatorit). 2 orë
- Prezantimi në gjuhën C. 2 orë
- Tipet e të dhënave. 2 orë
- Emrat dhe deklarimi i variablave. 2 orë
- Operatorët aritmetike. 2 orë
- Operatorët e krahasimit. 2 orë
- Operatorët logjikë. 2 orë
- Operatorët e pre/post inkrementimit dhe dekrementimit. 2 orë
- Leximi i të dhënave nga tastiera. 2 orë
- Degëzimi i kodit (*IF Else*). 2 orë
- Cikli *for*. 4 orë
- Cikli *while*. 4 orë
- Cikli *do...while*. 4 orë
- Vektorët në gjuhën C. 2 orë
- Algoritme bazë me vektorë. 2 orë
- Algoritme bazë me matrica. 2 orë

e) **“Sisteme multimediale”, kl. 12 dhe kl. 13:** **(38 orë)**

- Informacioni multimedial. 2 orë

• Transmetimi i informacionit multimedial.	2 orë
• Paraqitja kompjuterike e tingullit.	2 orë
• Formatet audio.	2 orë
• Komunikimi njerëzor dhe e folura.	2 orë
• Konceptet bazë të imazheve.	2 orë
• Imazhet matricore.	2 orë
• Imazhet vektoriale.	2 orë
• Gjuha <i>Scalable Vector Graphics (SVG)</i> .	2 orë
• Struktura e dokumenteve SVG.	2 orë
• Ndërtimi i grafikëve nëpërmjet SVG.	2 orë
• Formatet e video-s.	2 orë
• Animimi kompjuterik.	2 orë
• Kompresimi i të dhënave.	2 orë
• Faqet Web, HTML.	2 orë
• Komandat bazë.	2 orë
• Përfshirja e imazheve dhe Video në faqe HTML.	2 orë
• Lidhjet brenda faqes dhe midis faqeve.	2 orë
• Organizimi i elementeve nëpërmjet tabelave.	2 orë

f) **“Baza të dhënash”, kl. 13:**

(50 orë)

• Modelet e të dhënave (modeli konceptual, logjik, fizik).	2 orë
• Bazat e të dhënave relacionale.	2 orë
• Ndërtimi i skemës logjike të bazës së të dhënave.	2 orë
• Veprimet e algjibrës relacionale.	2 orë
• Prezantim në gjuhën <i>SQL</i> .	2 orë
• Komanda <i>SELECT</i> .	2 orë
• Klauzola <i>WHERE</i> .	2 orë
• Operatorët e krahasimit dhe lidhëzat logjike.	2 orë
• Operatorët <i>Between, IN, LIKE</i> dhe <i>IS NULL</i> .	2 orë
• Funksionet e grupit.	2 orë
• Klauzola <i>HAVING</i> .	4 orë
• Query mbi disa tabela; <i>JOIN (EQUI, INNER, OUTER, CROSS Join)</i> .	6 orë
• Modifikimi i të dhënave (<i>INSERT, UPDATE, DELETE</i>).	3 orë
• Komandat DDL.	4 orë
• Tipet e të dhënave.	3 orë
• Integriteti i të dhënave.	4 orë
• <i>VIEW</i> -të.	2 orë
• Transaksionet.	4 orë